

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
26.07.2021			
Funksionet Dru. Jedn. Cl. Nr.	S. Klasifik. Kl. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Ndihmëçev En. Stranica No. Pages
03	47	1317	6



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT ZYRA E Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Numri i Dokumentit Doc. No.	02.3
Numri i Dosës No. Dosë	1624/4
Numri i Dokumentit Doc. No.	Pg
Data e Përcaktimit Date	26/07/2021
Prishtinë	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General

Date: 26.07.2021
 Ref: 080/2021

Për: z. Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm
Kopje: znj. Hykmet Bajrami, Kryesuese e MKMFP-së dhe Koordinatorit të KMFP-së
 z. Armend Muja, Kryesues i KBPT-së dhe Koordinatorit të KMFP-së
Tema: Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit
 "Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare"

I nderuar z. Osmani,

Në bazë të kërkesës suaj, gjeni të bashkangjitur Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit "Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare" i cili përcakton veprimet e ndërmarra, dhe ato që do të ndërmerren, për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ana e juaj

Për çdo informatë, ju lutemi të mos hezitoni të na kontaktoni në çdo kohë

Me respekt,

Arben Krasniqi
 Zv. Sekretar i Përgjithshëm



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General

PËR: ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT

NGA: ARBEN KRASNIQI, ZV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I ZKM-SË

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit "Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare"

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	E gjetura	Rekomandimet	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët Përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	3.1.1. Financime direkte pa thirrje publike dhe pa plotësimin e kritereve nga IP-të	Financimet direkte të OJQ-ve nga Zyra e Kryeministrit Nga ZKM janë financuar OJQ në vlerë prej 41,000 euro në mënyrë direkte pa thirrje publike, pa vlerësim të projektit dhe pa komision vlerësues. Financimi i OJQ-së me titull të projektit "Manifestimi i Javës së Egjiptiane - 24 Qershor" ka	Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunën e Prishtinës me qëllim që të sigurojnë një proces transparent dhe konkurrues gjatë	Fondet për manifestimin e ditëve të Komuniteteve nuk do të jepen më sipas vendimit të nënshkruar në kohën e z. Isa Mustafa.	Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve		Drejtori i Zyrës duhet me e respektu dhe me punu sipas planit të cilin e kam përgatitur.

		<p>përfituar fonde në vlerë prej 12,000 euro, financimi i OJQ-së me titull "Festimi i Pavarësisë" në vlerë prej 9,000 euro dhe "Manifestimi i ditës së Komunitetit Turk" në vlerë prej 20,000 euro gjatë vitit 2019.</p> <p>Këto financime direkte janë arsyetuar përmes një vendimi të Qeverisë të vitit 2017 i cili kishte të bënte me financimin e festave të komuniteteve të Kosovës. Pavarësisht kësaj, ky vendim ishte për vitin 2017 andaj, kjo nuk e arsyeton financimin direkt pa thirrje publike për vitin 2019.</p>	<p>financimit të OJQ-ve duhet të ndërpresin përkrahjet direkte, vetëm me vendime të udhëheqësve të institucioneve.</p>				
2	<p>3.2.3. Dobësitë gjatë procesit të financimit të OJQ-ve nga IP-të</p>	<p>Një OJQ në kuadër të ZKM-së ka përfituar fonde për dy projekte të ndryshme nga dy Zyra në ZKM. Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë Rini dhe Sport ka financuar projektin me titull "Forcimi i kapacitetit të rinjve për të krijuar politika rinore në veri të Kosovës"19 në vlerë prej 14,010 euro dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhë ka financuar të njëjtën OJQ me projektin "Përmirësimi i përdorimit të gjuhëve zyrtare në punën e Policisë së Kosovës në veri të Kosovës"20 në vlerë prej 7,800 euro.</p> <p>Kjo OJQ udhëhiqet nga personi i cili në të njëjtën kohë është i emëruar edhe si anëtar i bordit të Komisionerit për Gjuhët në kuadër të ZKM-së. Ky bord udhëheq dhe është përgjegjës për hartimin, zhvillimin, zbatimin dhe fuqizimin e politikave për gjuhët të cilët shqyrtojnë dhe</p>	<p>ZKM-ja nuk ka bërë përpjekje që të shmang konfliktin e interesit gjatë procesit të vlerësimit të OJQ-ve. Si rezultat, financimi i OJQ-ve të cilat paraqesin konflikt interesi, rrit rrezikun për devijimin nga objektivat strategjike të institucionit dhe dështimin në arritjen e qëllimeve të synuara. Kjo ndikon në shfrytëzimin jo efikas dhe efektiv të parasë publike dhe mundëson ndarjen e fondeve në mënyrë të njëanshme</p>	<p>ZKQJ-ja e ka shqyrtuar rekomandimin e auditorit dhe gjatë konsultimeve paraprake me të njëjtën për të sqaruar ecurinë e financimit të OJQ-ve, ZKQJ është zotuar se tani e tutje do të ketë kujdes të shtuar në parandalimin e konfliktit të interesit, e në raste të paqartësive do të konsultohet me Institucionet relevante. Gjithashtu, si veprim i planifikuar për tu ndërmarrë për</p>	ZKQJ	<p>Përgjatë vitit 2021, në momentin e shpalljes së Thirrjes publike, Zyra do të ketë kujdes të shtuar në zbatim të rekomandimeve. (Parandalim të konfliktit të mundshëm të interesit).</p>	

		<p>vlerësojnë në baza vjetore punën e zyrës në kuadër të ZKM-së. Edhe pse udhëheqësi i kësaj OJQ-je paraqet konflikt të mundshëm të interesit mes IP-së dhe OJQ-së, një gjë e tillë nuk është paraqitur nga komisioni vlerësuese dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhët. Udhëheqësi i kësaj Zyre ka pohuar se ishte i njoftuar për këtë mirëpo nuk ka konsideruar se një rrethanë e tillë mund të paraqes konflikt interesit.</p>	<p>Zyrën e Kryeministrit të shmang financimet e OJQ-ve të cilat paraqesin konflikt interesit në mënyrë që të ofroj proces transparent dhe konkurrues për të gjithë.</p>	<p>parandalim të konflikt interesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në shpalljen e thirrjes për propozim do të potencohet se Zyra është e vendosur që në rast se vërtetohet konflikt interesit, pala e interesuar do të diskualifikohet nga gara. Në formularët e vlerësimit do të shtohet një pyetje për verifikim dhe shmangje të konflikt të interesit. Si dhe me rastin e nënshkruarjes së kontratës do të potencohet elementi i konflikt interesit. 			
3	<p>3.3.1 Institucionet financuese publike nuk raportojnë mbi financimet e OJQ-ve</p>	<p>Në kuadër të ZKM-së, Zyrat të cilat kanë financuar OJQ-të gjatë vitit 2019 nuk kanë bërë përpjekje për të raportuar financimet përmes raporteve përfundimtare. Zyra për Barazi Gjinore dhe Zyra për Çështje të Komuniteteve nuk kanë bërë përpjekje për të hartuar dhe përcjellë raportet vjetore të financimit në mënyrë që të ofrojnë transparencë mbi financimin e OJQ-ve. Në anën</p>	<p>Zyrën e Kryeministrit të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për themelimin e mekanizmave monitorues për të përcjellur ecurinë e projektit që të sigurohen se</p>	<p>ABGJ ka ndërmarrë veprimet e menjëhershëm për raportim të ZQM-ja me kohë gjatë vitit 2020.</p>	<p>Shefja e Divizionit për Administratë Buxhet dhe Financa-ABGJ.</p>	<p>Rekomandimi i zbatuar gjatë vitit 2020, ABGJ ka raportuar në kohë tek ZQM.</p>	<p>Ë gjetura është pjesërisht e sakët në rastin e ABGJ-së, sepse ne kemi hartuar raporte monitorimi për financimin e OJQ-ve, mirëpo nuk janë raportuar në kohë tek ZQM.</p>

		tjetër Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë Rini dhe Sport dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhë, edhe pse në kuadër të ZKM-së, kanë hartuar dhe përcjellë raportet përfundimtare. Janë dhënë arsytetime nga Zyra për Barazi Gjinore se për shkak të gjendjes së pandemisë nuk kanë arritur të zbatojnë këtë kriter, megjithatë, një arsyetim i tillë nuk qëndron për arsye se IP-të janë të obliguara që këto të dhëna t'i paraqesin deri më datë 1 mars 2020, ndërsa periudha e pandemisë ka filluar në mesin e muajit mars.	financimet po arrijnë qëllimet e synuara.				Për më tepër ABGJ-ja në faqe 20 të raportit të auditorit është gjetur si i vetmi institucion që kishte hartuar raporte monitorimi.
4	3.3.2. Zyra për Qeverisje të Mirë nuk ka regjistruar të dhënat e financimeve të OJQ-ve në bazën e të dhënave	ZQM-ja ka pranuar të dhënat e financimeve të OJQ-ve nga IP-të dhe bazuar në këto të dhëna dhe duke iu referuar shpenzimeve të thesarit ka përgatitur raportin vjetor për vitin 2019. Njëkohësisht ishte e obliguar që të dhënat e njëjta të financimit të OJQ-ve t'i publikoj dhe t'i bëjë të qasshme në bazën e të dhënave në web-faqe. Në lidhje me këtë, ZQM kishte zhvilluar platformën online dhe web-faqen ku kishte publikuar disa të dhëna të OJQ-ve dhe financimeve mirëpo nuk kishte arritur të bëjë përditësimin e plotë dhe për të gjitha financimet e realizuara. Këto të dhëna pasqyronin vetëm emërtimin e OJQ-së dhe shumën totale të përfituara nga IP-të, ndërsa nuk ishin pasqyruar të dhënat tjera të rëndësishme (sikurse emri i projektit,	Zyra e Kryeministrit përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë të bëjë raportim të plotë dhe të detajuar për projektet e financuara të OJQ-ve për vitin përkatës.	Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në kuadër të Platformës për Financimin Publik për OJQ-të (https://ojqfinancime.rks.gov.net): • do ta avancojmë dhe mundësojmë transparencë dhe qasje më të plotë të shpenzimeve të buxhetit për sektorin e shoqërisë civile për vitet në vijim • do të punojmë për të ofruar dhe	Zyra për Qeverisje të Mirë (Habit Hajredini , Trëndelin ë Dreshaj)	Dhjetor 2021	Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit është duke punuar në themelimin e një mekanizmi të përhershëm i cili do të koordinoj punën e raportimit për financimin e OSHC-ve në kuadër të secilës ministri dhe komunë. Ky mekanizëm pritet të themelohet dhe funksionalizohet deri në fund të vitit 2021. Sipas

		<p>qëllimi i projektit, titulli i thirrjes, numri i projekteve që kanë realizuar OJQ-të, departamenti financues, etj). Bazuar në arsyetimet e ofruara nga ZQM-ja për shkak të mungesës së resurseve njerëzore, nuk kanë arritur që të evidentojnë të gjitha të dhënat e projekteve të financuara nga IP-të gjatë vitit 2019. Po ashtu institucionet e caktuara të cilat kanë financuar OJQ-të nuk kanë përcjellë në ZQM të dhënat e plota dhe të sakta mbi financimin sikurse kërkohet, andaj, edhe kjo është njëra nga arsyet e ngecjeve në evidentimin dhe publikimin e të dhënave në ZQM. Si rezultat, mungesa e evidentimit dhe publikimit të të dhënave nga ZQM në web-faqe nuk ofron pasqyrim të plotë mbi financimin e OJQ-ve, për palët e interesuara dhe për qytetarët. Për më tepër palët e interesuara nuk mund të vlerësojnë ndikimin e këtyre financimeve bazuar në këto të dhëna të mangëta.</p>		<p>pasqyruar të gjitha të dhënat për raportim të shpenzimit të parasë publike për OJQ-të si e kërkon rregullorja</p> <ul style="list-style-type: none"> me përditësimet te platforma do të pasqyrohen dhe paraqiten detaje të shumta në lidhje me shpenzimet si: fushat e targetuara, aktivitetet, e të tjera, dhe rrjedhimisht të dhënat dhe data baza do të konsolidohet edhe më shumë për ta bërë një raportim sa më të plotë dhe të detajuar për projektet e financuara për OSHC-të. 			<p>planit çdo ministri dhe komunë do ta ketë një zyrtarë përgjegjës i cili do të raportoj dhe bëjë mbledhjen e raporteve për financim publik për OJQ-të në kuadër të institucionit që përfaqëson.</p>
5	<p>3.3.4. Mungesa e monitorimit të projekteve të financuara nga institucionet publike</p>	<p>Nga projektet e analizuar në ZKM në vlerë prej 164,880 euro, kemi vlerësuar nëse janë marrë vendime për caktimin e personave përgjegjës për secilën kontratë të lidhur me OJQ-të dhe nëse janë monitoruar projektet. Kemi identifikuar se përveç për një kontratë me OJQ (me titull të projektit "Fuqizimi i</p>	<p>Mungesa e caktimit të personave apo ekipeve monitoruese për kontratat e financuara të OJQ-ve tregon se IP-të nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të siguruar se mjetet e</p>	<p>Do të ketë transparence dhe raportim mbi financimet te OJQ-ve. Vendimi për komision monitorues nga ZÇK ekziston por</p>	<p>Drejtor i Zyrës per Çështje të Komuniteteve dhe ZKGJ-së.</p>	<p>Qysh gjatë verifikimit të dokumentacionit të OJQ ve të përzgjedhura për verifikim nga ana e auditorëve të</p>	<p>Duhet të ndryshohet vendimi pasi që një anëtar i komisionit është ne pushim të lehonisë.</p>

	<p>gruas në kultivimin e bletarisë” në kuadër të Zyrës për Barazi Gjinore ku është hartuar raporti i monitorimit nga personi i caktuar monitorues), projektet tjera nuk kanë persona/ekipe përgjegjëse të caktuar për monitorimin e projektit. Për pasojë mbi 95% e projekteve të audituara nuk janë monitoruar në kuadër të ZKM-së.</p> <p>ZKM-ja për vitin 2019, nuk ka monitoruar projektet të cilat janë financuar dhe si rezultat nuk ka një vlerësim nëse është arritur qëllimi i synuar dhe vlera për para. Përveç Zyrës për Komunitete e cila ka arsyetuar këtë me mungesë të personelit (me mungesë të resurseve humane për secilën kontratë) zyrat tjera në kuadër të ZKM-së nuk janë treguar të përgjegjshëm në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për caktimin e personave përgjegjës monitorues të projekteve. Përderisa, është e precizuar qartë se nëse IP-ja nuk arrin të bëjë monitorimin e zbatimit të projekteve (që nënkupton se nuk ka resurse) nuk duhet të bëjë shpallje për financimin e OJQ-ve. Pavarësisht kësaj, IP-të kanë financuar OJQ-të.</p>	<p>shpenzuara arrijnë qëllimet e synuara. Për më tepër mungesa e monitorimit nuk ofron siguri për zbatimin e objektivave strategjike si dhe arritjen e rezultateve.</p>	<p>komisioni nuk ka dal asnjëherë në teren, monitorimin e kanë bërë në baze të raporteve.</p> <p>ZKGJ ka marrë hapa konkret. Me vendimin 016/2021 është caktuar ekipi monitorues, i përbërë nga dy zyrtarë të ZKGJ-së. Si rezultat i monitorimit Zyra ka hartuar Raportin e monitorimit të projekteve (e protokolluar me nr.413/2) dhe ka hartuar raportin përfundimtar i zbatimit të projekteve nga thirrja publike për vitin 2020.</p>		<p>jashtëm, Zyra ka ndërmarrë iniciativën për të krijuar komisionin monitorues për shpalljen e thirrjes të vitit pasues (2020).</p> <p>Është zbatuar menjëherë.</p>	
--	--	---	--	--	---	--